



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ANILA Q. KAÇUPI
ADRESA NR.10, RESHIT COLLAKU,
AURORA, NR.1, NR.8
TEL: 676049924

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1952

Nr. koleksioni: 1160

Tirane më 14/04/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023052940067489559



A2023052940067489559

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Sot, më datë 14.04.2023, para meje Notere ANILA Q. KACUPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, RESHIT COLLAKU, AURORA, NR.1, NR.8, u paraqit personalisht:

SHITES: Juljan Morina, atësia Muharrem, amësia Myhrije, shtetas Shqiptar, lindur në Havaleas, Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Alla 03910008; Nd. 3; H. 9; Ap. 16; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 15/03/1972, gjendja civile “i divorcuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036138781 dhe nr. personal H20315036B.

BLERES: Shoqëria TEKNO FIRE, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L01307010S, me adresë Autostrada Tirane-Elbasan, Km 2, Ndodhur Ne Zkad 366, Ndertese Me Dy Kate; Kati I-Re, përfaqësuar nga Administratori Gramoz Çejku, atësia Qani, amësia Hirije, shtetas Shqiptar, lindur në Lusen, Kukës dhe banues në KAMËZ, me adresë Muharrem Bajraktari 03940180; Nd. 13; H. 1; Paskuqan; Paskuqan; 1047; Kamëz, lindur më 20/04/1988, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033849320 dhe nr. personal 180420143C.

PARASHTRIME

MEQENËSE:

(a) **Shitësi** është ortak i vetëm në shoqërinë **Morina Solar Shpk**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që vepron sipas ligjit shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKR me nr. NUIS - M21828050I – me seli në adresën Rruga Hamdi Garunja, Nd. 1, H.1, Nr.1, Lagjja nr.13, Njesia Administrative Farke, Tirane, Shqipëri, duke zotëruar 100% të kapitalit të saj themeltar, siç rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar.

ATËHERË, duke pasur parasysh sa me sipër Palët bien dakord si vijon:

1. PARASHTRIMET

1.1 Të gjitha parashtrimet e mësipërme janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e kësaj Kontrate.

2. OBJEKTI I KONTRATËS

2.1 Objekti i kësaj Kontrate është shitblerja nga Shitësi tek Blerësi e të gjitha kuotave në pronësinë e tij në shoqërinë Morina Solar Shpk, që përbëjnë 100% të kapitalit të saj (në vijim quajtur “**Kuotat**”).

3. ÇMIMI I SHITJES

3.1 Shitësi dhe Blerësi bien dakord se çmimi i shitjes për blerjen e 1 Kuote që është në pronësi të Shitësit dhe që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë është në vlerën e 416.000 (katërqind e gjashtëmbëdhjetëmijë) euro.



A2023052940067489559

- 3.2 Çmimi i Shitjes si më sipër përfaqëson shumën totale dhe të vetme të detyrimit që Blerësi ka ndaj Shitësit për blerjen e Kuotave. Ky është çmim neto që kalon në llogarinë bankare të Shitësit, ku nuk janë të përfshira tatimet, të cilat do të paguhen nga blerësi për llogari të shitësit.

4. SHLYERJA E ÇMIMIT TË SHITJES

- 4.1 Blerësi dhe Shitësi deklarojnë e pranojnë se Çmimi i Shitjes do të bëhet me transfertë bankare, nga Blerësi tek Shitësi në vlerë të plotë ose me këste brenda datës 30 prill 2023.

5. MARRËVESHJET RECIPROKE TË PALËVE

- 5.1 Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe të angazhohen maksimalisht për të kryer të gjitha aktet e veprimet e nevojshme për realizimin e kushteve të kësaj Kontrate brenda afateve përkatëse të parashikuar në të.

6. MOMENTI I KALIMIT TË KUOTAVE

- 6.1 Kalimi i Kuotave nga Shitësi tek Blerësi, bëhet me lidhjen e kësaj Kontrate dhe pas pagimit të çmimit të shitjes së kuotave në llogarinë bankare të shitësit. Në rast të mos pagimit të çmimit të shitjes së kuotave në llogarinë bankare të shitësit brenda brenda datës 30 prill 2023, kjo kontratë do të konsiderohet e zgjidhur dhe blerësi nuk ka asnjë pretendim ndaj shitësit në lidhje me kuotat e shoqërisë. Vetëm pas kryerjes së pagesës Blerësi ka të drejtë të regjistrojë këtë kontratë pranë QKB për ndryshimin e pronësisë
- 6.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi bëhet pronar i vetëm dhe i ligjshëm i 1 (një) Kuote të Shoqërisë "Morina Solar" shpk, të shitura nga Shitësi dhe që përbëjnë 100% të kapitalit të saj;
- 6.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi pranon të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kjo shoqëri ka në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe shitësi përjashtohet nga cdo detyrim që mund të lind në shoqëri pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

7. REGJISTRIMI I KALIMIT

- 7.1 Kjo Kontratë do të dërgohet për regjistrim nga pala Blerëse pranë regjistrimit tregtar të QKB-së si dhe në regjistrat e tjerë sipas parashikimeve ligjore dhe do të bëhet me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe pas pagimit të çmimit të shitjes së kuotave në llogarinë bankare të shitësit.

8. DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi i deklaron dhe garanton Blerësin

8.1 Gjendja e Shoqërisë

Shoqëria Morina Solar Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që vepron sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numrin unik të identifikimit NUIS – M21828050I, me seli në Rruga Hamdi Garunja, Nd. 1, H.1, Nr.1, Lagjja nr.13, Njesia Administrative Farke, Tirane, Shqipëri. Shoqëria është themeluar rregullisht dhe nuk ekzistojnë shkaqe që mund të sjellin pavlefshmërinë apo nulitetin e themelimit të Shoqërisë. Ajo është në gjendje të mirë dhe nuk i



A2023052940067489559

është nënshtruar procedurave të falimentimit, likuidimit apo procedurave të ngjashme me to.

8.2 **Pronari i Ligjshëm**

Shitësi është pronari i ligjshëm i 1 (një) Kuote objekt i kësaj Kontrate, dhe i ka fituar ato në mënyrë të ligjshme dhe Shitësi ka të drejta të plota për kalimin e Kuotave tek Blerësi sipas ligjit.

8.3 Shitësi deklaron që kuotat që transferohen nuk janë të barrësuara dhe të vendosura peng. Blerësi deklaron se i blen kuotat në gjendjen që janë.

9. **KOMUNIKIMET DHE NJOFTIMET**

9.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera sipas kësaj Kontrate, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Palëve në adresat e deklaruara në hyrjen e kësaj Kontrate.

9.2 Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat, ose komunikimet e tjera sipas kësaj Kontrate, prezumohen të kryera rregullisht, kur njoftimi, kërkesa apo komunikimi është: (i) dërguar personalisht, (ii) dërguar me letër porosi me kthim përgjigje, ose i është (iii) dorëzuar një shoqërie ndërkombëtare të mirënjohur të shërbimit të shpejtë postar, në adresat e deklaruara në hyrjen e kësaj Kontratë.

9.3 Palët dhe mund të ndryshojnë herë pas here adresat e deklaruara, duke njoftuar me shkrim të paktën 5 (pesë) ditë më parë Palën tjetër.

9.4 Pavarësisht prezumimeve të mësipërme, çdo njoftim apo komunikim i cili është kryer/marrë efektivisht nga Palët në mënyra të ndryshme nga sa më sipër, nuk do të konsiderohet i pavlefshëm vetëm për faktin se dispozitat e paragrafëve 9.2 më sipër nuk është zbatuar.

10. **TË NDRYSHME**

10.1 **E gjithë Marrëveshja**

Kjo Kontratë, duke përfshirë dhe Parashtrimet, përfaqëson marrëveshjen e plotë të lidhur ndërmjet Palëve në lidhje me shitblerjen e kuotave, dhe ka përparësi ndaj çdo kontrate apo marrëveshje tjetër, verbale apo të shkruar, në lidhje me objektin e saj.

10.2 **Ndryshime**

Palët nuk mund të heqin dorë, ndryshojnë, modifikojnë, këtë Kontratë apo ndonjë parashikim të saj, përveçse me anë të një akti tjetër me shkrim të lidhur ndërmjet tyre. Çdo ndryshim si më lart do të prodhojë efekte duke filluar nga nënshkrimi i aktit ndryshues nga përfaqësuesi/it i/e autorizuar të të dyja Palëve (përveçse nëse është rënë dakord që hyrja në fuqi të bëhet në një datë të mëvonshme).

10.3 **Pavlefshmëria**

Nëse ndonjë kusht apo dispozite e kësaj Kontrate shpallet e pavlefshme ose e paligjshme ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Kontratës, për sa është e mundur, do të mbeten në fuqi e të zbatueshme rregullisht. Në këto raste, Palët në mirëkuptim do të mundohen të zëvendësojnë pa yonesa dispozitat e pavlefshme/paekzekutueshme, me dispozita të vlefshme, me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj Kontrate.



A2023052940067489559

10.4 Gjuha

Kjo Kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të njëjta, në gjuhën shqipe. Çdo njoftim, komunikim apo dokument tjetër që duhet të transmetohet ndërmjet Palëve sipas kësaj Kontrate duhet të jetë në gjuhën shqipe.

10.5 Heqja Dorë

Asnjëra prej Palëve nuk do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ndonjë e drejte sipas dispozitave të kësaj Kontrate, përveç kur dorëheqja është bërë shprehimisht me shkrim. Mos kryerja e përpjekjeve nga secila Palë për të kërkuar përmbushjen e saktë e në kohë, të drejtave që i lindin sipas kësaj Kontrate, nuk do të interpretohet si heqje dore nga kjo e drejtë.

10.6 Ligji i Zbatueshëm

Kjo Kontratë do të rregullohet nga dhe në përputhje me ligjin shqiptar.

10.7 Juridiksioni

Nëse për çfarëdolloj arsye, Palët nuk arrijnë të zgjidhin në mirëkuptim një mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e dispozitave të mësipërme, (vijim Mosmarrëveshja), atëherë, Palët bien dakord se Mosmarrëveshja do të zgjidhet nga gjykatat kompetente sipas Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Unë, noterja, anëtare e dhomës së noterëve Tiranë, lexoj me zë të lartë tekstin e kësaj Kontrate, dhe pasi palët njihen me përmbajtjen e saj dhe pasi e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, e nënshkruajnë rregullisht në praninë time dhe unë noterja e vërtetoj këtë dokument sipas ligjit.

SHITËSI

Juljan Morina

BLERËSI

Shoqëria Tekno Fire

Administratori

Gramoz Çejku

Noter

ANILA Q. KACUPE

